



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-317
21.10.2022
Shkup

Në pajtim me nenin 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20; nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (teksti i konsoliduar) (nr.y në ark.01-3732/1 datë 29.7.2019, njoftimin për ndërprerjen e kryerjes së veprimtarisë nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KANAL-21 SHPKJNP Veles (PA1 nr.08-317 datë 5.10.2022), plotësim – njoftim për ndërprerjen e kryerjes së veprimtarisë (PA1 nr.08-317 datë 10.10.2022) dhe konkluzionin me nr.ark.02-3850/2 datë 21.10.2022, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 40-të mbajtur më 20.10.2022 miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KANAL-21 SHPKJNP Veles FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve.
2. Ky aktvendim botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në ueb-faqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim është përfundimtar.

A r s y e t i m

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) televizioni KANAL-21 SHPKJNP Veles, është posedues i lejes për transmetim televiziv me nr.08-49 datë 5.1.2015, me vlefshmëri prej 9 (nëntë) vitesh (nga 5 janar 2015 deri më 4 janar 2024), për transmetim nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurse të kufizuara, në nivel lokal në zonën e Komunës së Velesit, Komunës së Çashkës dhe Komunës së Gradskos, shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhë maqedonase.

Më datë 5.10.2022 Televizioni SHTR KANAL-21 SHPKJNP Veles, në mënyrë elektronike në adresën zyrtare e-mail (contact@avmu.mk) të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) dorëzoi njoftim për ndërprerje të kryerjes së veprimtarisë (PA1 nr.08-317), krahas së cilës është dorëzuar deklarata për përfundimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim televiziv në bazë ligjore, e dorëzuar nga Zoran Stavrev nga Velesi, në cilësinë e udhëheqësit (menaxherit) dhe themelues/pronar i vetëm i transmetuesit, i noterizuar me UZP nr.6279/2022 të datës 5.10.2022, i cili deklaron se televizioni SHTR KANAL-21 SHPKJNP Veles përfundimisht më 8.9.2022 ndërpreu së transmetuari programin televiziv. Nga kontrolli i deklaratës së dorëzuar, Agjencia konstatoi se

në të duhet të kryhen korrigjime të caktuara. Nga sa u tha më lart, televizioni SHTR KANAL-21 SHPKNJP Veles, në mënyrë elektronike, në adresën zyrtare të postës elektronike e-mail (contact@avmu.mk) të Agjencisë ka dorëzuar një shtesë – njoftim për ndërprerje të kryerjes së veprimtarisë (PA1 nr.08-317 të datës 10.10.2022,) duke bashkëngjitur si shtojcë deklaratën e re të korrigjuar dhe të dorëzuar nga Zoran Stavrev nga Velesi, në cilësinë e udhëheqësit dhe themeluesit/pronarit të vetëm të transmetuesit, e noterizuar UZP nr.6365/2022 të datës 10.10.2022, i cili deklaron se televizioni SHTR KANAL-21 SHPKNJP Veles që nga 7.9.2022 ka ndërprerë transmetimin e programeve televizive. Transmetuesi në fjalë nuk ka (posedon) borxh ndaj Agjencisë.

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), leja për transmetim në radio ose televizion ndalon të vlejë sipas fuqisë ligjore dhe me deklaratën me shkrim ku poseduesi njofton Agjencinë se ka ndaluar transmetimin e programeve në radio dhe televizion. Për përfundimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim në radio ose televizion në bazë ligjore Këshilli nuk miraton vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve nëse lejes i ka mbaruar afati sipas fuqisë ligjore (neni 85, paragrafi (2)).

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, dhe në bazë të nenit 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAV-së, si dhe deklaratën me shkrim të lartpërmendur dhe të noterizuar UZP me nr.6365/2022 të datës 10.10.2022, janë plotësuar kushtet ligjore për fshirjen e transmetuesit të SHTR Televizioni KANAL-21 SHPKNJP Veles nga regjistri i transmetuesve.

Në pajtim me nenin 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMA, deklaratë për ndalimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim televiziv sipas fuqisë ligjore, e dorëzuar nga Zoran Stavrev nga Velesi, në pozitën e udhëheqësit dhe themelues/pronar i vetëm i televizionit SHTR KANAL-21 SHPKNJP Veles, i noterizuar UZP, nr.6365/2022 datë 10.10.2022, dhe në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale me nr. ark. 01-3732/1 datë 29.7.2019 dhe konkluzioni me nr. ark.02-3850/2 datë 21.10.2022, është marrë vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale,
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.